

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rustem Begolli, me zyratën ligjore Sanije Troshupa, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vendosur në çështjen penale kundër të Pandehurit Sh.D., nga P.1, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.1043/2017 të datës 06.12.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, me datën 11.05.2018, në të cilën ishin prezent Prokurori i Shtetit Rukije Shashivari, i pandehuri Sh.D., në prezencën e palëve, me datë **11/05/2018**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Sh.D., i lindur më ..., në P.1, nga i ati E. dhe e ëma I., e gjinisë T., tani me vendbanim në fshatin R., Komuna P.2, i martuar, ka kryer shkollën e mesme, e gjendjes së dobët, ekonomike, nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: Me datë 30.01.2017, rreth orës 16:30, në rrugën “V.F.”, në P.1, në afërsi të lokalit “F.”, i pandehuri Sh.D., duke e drejtuar automjetin e tipit “Passat”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 41 par. 1, të Ligjit nr.05/L – 088, për Rregullat e Trafikut Rrugor, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, ashtu që duke mos i’u përshtatur kushtëve dhe rrethanave të rrugës, kalon në kahjen e kundërt të drejtimit të lëvizjes, dhe me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit e godet automjetin e tipit “VW Golf V”, ngjyrë e kaltërt, me targa të regjistrimit ..., të cilën e drejtonte i dëmtuari G.H., në pjesën e pasme, me ç’rast shkaktohet aksident komunikacioni me dëme materiale si dhe i dëmtuari G.H., ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin;-

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 41; 43; 46; dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 248; 359 dhe 365 të KPRK –së, të pandehurit **Sh.D.** i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit: **Sh.D.** i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **200.00 (dy qind Euro)** të cilin dënim, është i obliguar që t’a paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 46 par. 3, të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku **një (1) ditë** burgim do të llogaritet me **20 (njëzet)**, euro gjobë.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjeko ligjore shumë prej **20€**, për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88€** si dhe paushallin gjyqësor

në shumë prej 20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: **G.H.**, me vendbanim në fshatin T., Komuna P.1, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.1043/2017, të datës 06.12.2017, kundër të pandehurit Sh.D., për shkak të kryerjes së veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 KPRK – së.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin P.nr.5685/2017 të datës 13.02.2018, e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka lëshuar Urdhër ndëshkimor përmes së cilit të akuzuarin Sh.D. e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK – së, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katër qind) euro. Kundër këtij Aktgjykimi i pandehuri Sh.D. brenda afatit ligjor ka ushtruar kundërshtim.

Lidhur me këtë çështje penale kundër të pandehurit Sh.D., gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 11.05.2018.

Që në fillim të shqyrtimit fillestar, i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar nga gjykata një dënim sa më të lehtë pasi që gjndjen ekonomike e kam shumë të vështirë dhe jam mbajtës i familjes.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit Prokurori i Shtetit, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i akuzuari e ka pranuar akuzën në tërësi dhe është i vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe i ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, të cilin pranim të fajësisë e ka bërë pasi që gjykata e ka njoftuar në hollësi për natyrën dhe pasojat e pranimit të tillë, duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPPK-së, pikërisht se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuari, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike prandaj, gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPK-së.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve të parapara në nenin 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPK-së, gjykata nuk është lëshuar në nxjerrjen dhe administrimin e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, se i pandehuri e ka kryer veprën penale të lartcekur, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nisur nga pranimi i fajësisë, Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të cilën i njëjti edhe akuzohet. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoji si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit. Ashtu që për të pandehurin Sh.D., si rrethana lehtësuese gjeti se: i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt në gjykatë, morri parasysh, se nuk ka qenë e dënuar më parë, është i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti. Nisur nga të gjitha këto Gjykata i shqiptoi dënim me gjobë me bindje se në rastin konkret është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale e të pandehurit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, pra, dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.5685/2017, me datë 21.05.2018

Procesmbajtëse
Sanije Troshupa

Gjyqtar
Rrustem Begolli

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm përmes kësaj Gjykate.